



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 3454

Prishtinë, Dt. 24/09/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Departamenti i Fizikës / Msc Fizikë
Projektpropozimi	<p>"Njohuri mbi ndërveprimet molekulare në përzierjet binare dhe ternare të 1-butanolit, benzenit dhe acetofenonit. Një qasje eksperimentale dhe teorike"</p> <p>"Insights into molecular interactions in binary and ternary mixtures of 1-butanol, benzene and acetophenone. An experimental and theoretical approach"</p>
Kandidati	Rozafa Krasniqi
Mentori	Prof. Asoc. Fisnik Aliaj
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 28/02/2025
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 686
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Dorëshkrimi i temës së masterit të kandidatës Rozafa Krasniqi është shkruar në gjuhën shqipe dhe përfshin të gjitha pjesët përbërëse: hyrjen, pjesën teorike, pjesën eksperimentale, rezultatet dhe diskutimin, përfundimet dhe literaturën e përdorur.</p> <p>Në pjesën teorike, kandidatja ka trajtuar në mënyrë të detajuar madhësitë themelore eksperimentale – dendësinë dhe shpejtësinë e zërit – si dhe madhësitë e rrjedhura të llogaritura – vëllimet molare shtesë dhe devijimet në kompresibilitetin izentropik. Janë dhënë definicionet e nevojshme për përzierjet dhe komponimet organike, të domosdoshme për interpretim të qartë të rezultateve. Kandidatja ka identifikuar</p>

qartë grupet funksionale të përbërësve ( OH i 1-butanolit, unaza aromatike e benzenit dhe grupi karbonil i acetofenonit), si dhe ndërveprimet molekulare kryesore (lidhjet hidrogjenore, ndërveprimet  $\pi-\pi$  dhe ndërveprimet dipol-dipol), duke i lidhur ato me sjelljen termodinamike të sistemeve të studiuara.

Në pjesën eksperimentale janë përshkruar qartë materialet dhe metodat e përdorura, si dhe pajisjet laboratorike për matjen e dendësisë dhe shpejtësisë së zërit. Kandidatja ka ndjekur procedurat standarde të matjes dhe ka përfshirë detaje mbi kushtet e punës, dhe ka identifikuar kontributet e ndryshme gjatë vlerësimit të papërcaktueshmërive të madhësive të studjuara.

Në kapitullin mbi rezultatet dhe diskutimin, kandidatja ka paraqitur të dhënat eksperimentale të dendësisë dhe shpejtësisë së zërit për sistemet binare dhe ternare, si dhe madhësitë e rrjedhura të tyre. Rezultatet janë shoqëruar me tabela dhe grafikë ilustrues dhe janë interpretuar me një rend logjik: fillimisht sistemet binare dhe më pas sistemi ternar. Diskutimi është i qartë dhe i mbështetur në literaturën bashkëkohore, duke e bërë të kuptueshëm ndikimin e ndërveprimeve molekulare në sjelljen makroskopike të përzierjeve.

Përfundimet janë të argumentuara mirë dhe reflektojnë objektivat e hulumtimit. Kandidatja ka arritur të lidhë qartë ndërveprimet mikroskopike me vetitë makroskopike, duke theksuar rëndësinë e këtyre sistemeve si modele për studimin e sjelljes së përzierjeve të lëngshme. Aplikimi i modeleve matematikore (Redlich-Kister, Cibulka, Jouyban-Acree dhe modelet gjeometrike) është bërë në mënyrë të suksesshme, duke treguar zotërim të mirë të metodologjisë shkencore.

Punimi ka vlera të mirëfillta shkencore, qoftë në aspektin teorik, qoftë në atë praktik. Kandidatja ka demonstruar qasje sistematike dhe profesionale në hulumtim, përdorim të metodave të përshtatshme eksperimentale dhe analitike, si dhe shfrytëzim të literaturës bashkëkohore.

Në bazë të asaj që u cekë më lartë komisioni vlerëson se punimi i temës së masterit me titull:


**“Njohuri mbi ndërveprimet molekulare në përzierjet binare dhe ternare të 1-butanolit, benzenit dhe acetofenonit. Një qasje eksperimentale dhe teorike”**


të kandidatës **Rozafa Krasniqi** i plotëson kriteret për punim të Masterit.


Prandaj, komisioni për vlerësim të dorëshkrimit propozon që punimi i kandidatës **Rozafa Krasniqi** të pranohet si punim i temës së masterit dhe kandidatës t'i mundësoj mbrojtjen publike me qëllim të fitimit të gradës Master i Fizikës.

Prishtinë, 24/09/2025

Komisioni:

1.   
/ Prof. Asoc. Fisnik Aliaj – mentor/

2.   
/ Prof. Tahir Arbneshi – anëtar/

3.   
/ Prof. Naim Sylaj – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.